

Inicijativa për dialogjet strategjike
Grupi punues “Arsim”
(mars/nëntor 2004)

Analiza e gjendjeve në arsim dhe rekomandimet për tejkalimin e tyre

Shkup, 21 Tetor 2004

MULTIKULTURALIZMI NË ARSIM

Përshkrimi i gjendjes momentale

Sistemi arsimor në Maqedoni ka qenë dhe ende paraqet faktor që kontribuon për ndarjen ndërmjet grupeve etnike dhe forcimin e tensioneve ndëretnike. Gjendja e tillë është rezultat i disa karakteristikave të sistemit arsimor: (1) paralelizmi gjuhësor/etnik, (2) orientimi etnocentrik dhe (3) qasja tradicionale.

1. Paralelizmi gjuhësor/etnik

Mësimi në shkollat fillore dhe të mesme realizohet në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe serbe, me çka ndarja gjuhësore në masa të mëdha përputhet edhe me atë etnike (veçanërisht kur bëhet fjalë për bashkësinë shqiptare dhe turke). Në shkollat, po edhe në ato me përberje të përzier në të cilat mësimi zhvillohet në dy ose tre gjuhë, nuk ofrohen kurfarë aktiviteteve nëpërmjet të cilave do të siguroheshte komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet nxënësve që u takojnë grupeve të ndryshme etnike.

Përkundrazi, në emër të pengimit të konflikteve ndëretnike, nxënësit të cilët e përcjellin mësimin në gjuhë të ndryshme, ndahen në ndërrime ose ndërtesa (nëse ndërtesa amë nuk është e mjaftueshme për të gjithë nxënësit).

Mungesë e njejtë e bashkëpunimit ekziston edhe ndërmjet arsimtarëve të cilët ligjerojnë në gjuhë të ndryshme dhe shpesh u përkasin grupeve të ndryshme etnike. Studentët të cilët përcjellin mësimin në ndonjë fakultet pedagogjik, nuk kanë mundësi të komunikojnë dhe të ndërtojnë përvoja me studentët të bashkësive tjera etnike gjatë kohës së studimit. Ndarja e kështillë e arsimtarëve të ardhshëm i bën studentët më pak të aftë për ti tejkaluar stereotipet dhe paragjykimet negative për pjesëtarët e bashkësive tjera.

2. Orientimi etnocentrik

Kurikullimet nga lënda e Historisë dhe Letërsisë janë kryesisht etnocentrike – ose ekziston mungesa e përmbajtjeve për “të tjerët”, ose ngritja e etnikumit personal në llogari të “tjerëve”. Nxënësit të cilët e përcjellin mësimin në gjuhën maqedonase mësojnë shumë pak nga Historia dhe Letërsia e të “tjerëve”, dhe atë pak që e mësojnë kontribuon kryesisht për stereotipet dhe paragjykimet negative për të “tjerët”. Për nxënësit të cilët e përcjellin mësimin në gjuhët tjera janë të parapara më shumë përmbajtje për Historinë dhe letërsinë e etnikumit të tyre, por si shtesë e kurikullimeve në gjuhën maqedonase, që shumë shpesh shkakton futjen jooficiale të përmbajtjeve plotësuese me të cilat ngritet etnikumi personal. Etnocentrizmi në përmbajtjet e lëndës së historisë dhe letërsisë, pa marrë parasysh gjuhën në të cilën vijon është burim i vazhdueshëm i nacionalizmit në kuptim shumë radikal.

3. Qasja tradicionale

Sistemi arsimor në Maqedoni (prej atij parashkollor deri te ai universitar) ende promovon arsim dhe mësim të orientuar në marjen e diturisë nëpërmjet memorimit të thjeshtë, me mungesë plotë të menduarit kritik dhe kreativ. Si rezultat i kësaj, nxënësit shëndërohen në qytetar të cilët janë egër, të paaftë për ta shprehur mendimin e tyre, dhe lehtë u nënshtrohen ndikimeve dhe manipulimeve. Situata e këtillë është tokë pjellore për kujdesjen e stereotipeve dhe paragjykimëve negative dhe për zhvillimin e jotolerancës për të tjerët që janë të ndryshëm.

Njëkohësisht, nëpër shkollat në Maqedoni sundon atmosferë autoritative me mungesë të demokracisë së vërtetë. Fakti se të gjitha vendimet (edhe ato që kanë të bëjnë me aktivitetet joformale të nxënësve) që i sjell drejtorija e shkollës (nganjëherë në bashkëpunim me arsimtarët), i pengon nxënësit nga pjesmarja aktive në sjelljen e vendimeve. Në këtë mënyrë ulet vetë-respektimi të nxënësit që është parakusht për respektimin e të “tjerëve”. Njëkohësisht shtypet përgjegjësia sociale dhe stimulohen konformizmi dhe dëgjueshmëria të qytetarët e ardhshëm.

Përshkrimi i popullatës së brengosur

Sistemi arsimor në Maqedoni nuk është i aftë të edukojë për jetë në shoqëri multikulturore/multietnike. Më të brengosur nga kjo gjendje janë nxënësit, arsimtarët (të tanishëm dhe të ardhshëm) dhe prindërit.

Nëpërmjet mënyrës se cilës është e strukturuar dhe nëpërmjet përmbajtjeve dhe qasjes, sistemi arsimor (veçanërisht në nivelin fillestar dhe të mesëm) e zhvillon etnocentrizmin dhe nacionalizmin dhe i ushqen stereotipet dhe paragjykimet negative etnike të *nxënësit*.

Njëkohësisht e shtyp përgjegjësinë sociale të nxënësit dhe duke stimuluar konformizmin dhe dëgjueshmërinë, i bën të nënshtroshëm në shtypjet dhe manipulimet sociale.

Arsimtarët ishin pjesë e atij sistemi arsimor përderisa kanë qenë nxënës, e pastaj edhe studentë që janë pregaditur për arsimtarë. Të nënshtroar qasjes tradicionale në arsim gjatë kohës së studiimeve dhe të izoluar nga kolegët e tyre të etnikumeve tjera, ata vazhdojnë të përkujdesen për stereotipet dhe paragjykimet e fituara më parë dhe ta thellojnë konformizmin dhe dëgjueshmërinë personale, të gatshëm për ti përcjellur qëndrimet dhe vlerat e njejta nxënësve të tyre të ardhshëm.

Prindërit të cilët gjithashtu kanë dalë nga sistemi i tillë arsimor janë kryesisht dëshmitarë memec të ndryshimeve në sistemin shoqëror dhe nuk janë në gjendje të kuptojnë se mungesa e sistemit arsimor nuk është në atë se çka ndryshohet, por përkundrazi në atë se çka nuk ndryshohet sipas kërkesave të bëra në jetën e përditshme. Dhe në këtë mënyrë pasojat nga mospregaditja e sistemit arsimor që ti aftësojë nxënësit dhe arsimtarët e ardhshëm për jetesë në shoqëri multikulturore/multietnike i ndejnë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Rekomandime

1. Tejkalimi i paralelizmit gjuhësor/etnik nëpërmjet:

Mësimi të gjuhës së të “tjerëve”

Shkollat duhet tju mundësojnë nxënësve që vijojnë mësimin në gjuhën maqedonase të përvetësojnë një gjuhë që e flasin bashkësitë tjera etnike në Maqedoni. Në regjionet në të cilat ka edhe gjuhë të dytë zyrtare, ajo gjuhë duhet që patjetër të mësohet nëpër shkolla. Për këtë rast duhet të kyqet lëndë e veçantë prej klasës së parë.

Në anën tjetër nxënësit të cilët e përcjellin mësimin në gjuhët tjera, duhet që më seriozisht ta mësojnë gjuhën maqedonase prej klasës së parë. Me gjithë atë, mënyra në të cilën do të ligjerohet gjuha maqedonase (dhe gjuhët e etnikumeve tjera) duhet të bazohet në metodat më bashkëkohorë të mësimi të gjuhëve joamtare.

Zbatimi i arsimit alternativ bilingual

Modeli bilingual duhet të ofrohet si alternativë e modelit ekzistues monolingual të arsimit. Përvoja nga shkollat e mesme private tregon se nxënësit janë të përgaditur që një pjesë të lëndëve ti mësojnë në gjuhën e tyre amëtare, ndërsa një pjesë të lëndëve në një gjuhë tjetër. Qasja e tillë do të mundësojë përvetësim më të mirë të gjuhës joamtare dhe depërtim më të madh në të gjitha univrsitetet e vendit.

Zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta jashtë mësimore

Aktivitetet jashtëmësimore në shkollat me mësim në dy ose më tepër gjuhë duhet të zhvillohen me nxënës të përzier të grupeve të ndryshme etnike.

Arsimtarët kanë për detyrë që të mundësojnë komunikim të pandërprerë ndërmjet nxënësve në gjuhët që i flasin nxënësit. Kjo don të thotë se duhet që sërish të zhvillohet puna në sekcione ose të zbatohet puna e proekteve të përbashkëta në të cilën do të angazhohen në mënyrë të njejtë arsimtarët të cilët janë të kyqur në mësimin e të gjitha gjuhëve prezente në shkollë. Në këtë mënyrë do të krijohet bazë për bashkimin e anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike rreth interesave të përbashkëta.

Duhet të krijohen kushte për bashkëpunim të shkollave në të cilat mësimi zhvillohet vetëm në një gjuhë. Gjatë kësaj janë të mundshme aktivitete të ndryshme – nga vizitat reciproke deri te proektet e përbashkëta në të cilat do të theksohet intereakcioni ndërmjet nxënësve. Intereakcioni i tillë kërkon angazhim të veçantë të arsimtarëve të cilët duhet të paraqiten në rolin e lehtësuesve gjatë komunikimit.

2. Tejkalimi i orientimit etnocentrik:

Të futurit e përmbajtjeve për historinë, kulturën dhe traditën e të “tjerëve”

Në programet arsimore të historisë, letërsisë, muzikës dhe artit për nxënësit e të gjitha bashkësive etnike duhen të futen përmbajtje nëpërmjet të cilave nxënësit do të njoftohen me historinë, kulturën dhe traditën e bashkësive të ndryshme etnike në Republikën e Maqedonisë.

Nuk është e arsyeshme të kesh njohuri vetëm për historinë personale pa mos i ditur elementet kyq nga historija e bashkësive të ndryshme etnike në Maqedoni, sikurse nuk është e arsyeshme të mësohet ende për historinë botërore, e të lihet anash historija e bashkësive të ndryshme etnike me të cilët jeton në të njejtin shtet. E njejtja vlen edhe për letërsinë dhe artin.

Hudhja e stereotipeve dhe paragjyqimeve etnike nga arsimi

Nga mësimet e historisë dhe letërsisë duhet të hudhen të gjitha përmbajtjet të cilat i ushqejnë stereotipet dhe paragjykimet etnike për të “tjerët”. Prezentimi i ngjarjeve që janë me rëndësi të madhe për etnikumin e caktuar, dhe që kanë të bëjnë edhe me etnikum tjetër në Maqedoni, duhet ti kyqin pikëpamjet e dy etnikumeve tjera edhe atëher kur do të jenë të kundërshtuara. Vetëm në atë mënyrë mund ti iket njollosjes së etnikumit “tjetër” në llogari të ngritjes së etnikumit personal.

Nga të gjitha lëndët të cilat ligjerohen në shkolla duhet të hudhen shtesat ideologjike. Këtu është kyqës roli i arsimtarëve nga të cilët pritet që mos ti nxisin stereotipet etnike dhe të përmbahen nga paragjykimet etnike.

Përshatja e teksteve në librat e milës multikulturore

Në librat e të gjitha lëndëve tjera duhet të përdoren emra dhe simbole që u takojnë etnikumeve të ndryshme në Maqedoni. Për shembull në detyrat e matematikës në gjuhën maqedonase duhet të përmenden edhe emra të personave që është e njohur se u takojnë bahkësive tjera etnike, ndërsa në ilustrimet e materijaleve për njohjen e shoqërisë të përdoren edhe fotografi të gjamive. Por, duhet pasur kujdes që futja e të tjerëve të mos përmbajë asnjë konotacion negativ.

3. Tejkalimi i qasjes tradicionale:

Zhvillimi i të menduarit kritik dhe kreativ te nxënësit

Qasja frontale e arsimtarëve në mësim (ligjerim i pastërt) duhet të ndërrohet me qasje interaktive, në të cilën nxënësit vetëm do të jenë të udhëhequr nga arsimtarët (ose nëpërmjet punës në grupe) që ta mësojnë materijalin. Në këtë mënyrë kërkesa për memorim të thjeshtë të informatave do të ndërrohet me të menduarit kritik dhe kreativ, ndërsa nxënësit do të nxiten që të mendojnë më kokë të vetë (dhe të jenë të hapur për nevojat dhe qëndrimet e të “tjerëve”), në vend që ti riprodhojnë mendimet e huaja (dhe në mënyrë të verbër ti përcjellin qëndrimet që ju plasohen të “tjerëve”)

Demokratizimi i marrëdhënieve nxënës-arsimtarë-drejtori

Mungesa e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin e sjelljes së vendimeve në shkolla, ose pjesëmarrjen e tyre e rrejshme që është edhe më e dëmshme, duhet të ndërrohet me pjesëmarrje aktive, së pari në vendimet që i brengosin vetëm ata vetë e pastaj edhe në shumë vendime në nivel të shkollave. Me këtë do të zhvillohet përgjegjësia sociale te nxënësit dhe ata do të jenë rezistentë në manipulimet politike dhe të tjera.

PROFESIONALIZIMI DHE APOLITIZIMI

1. Hapat parandaluese

Këto dy komponenta si kualitativ i arsimit bashkëkohor nuk kyqen në përgjithësi, por funksionimi i tyre ngrit lartë kualitetin dhe ndërton autonomi relative të sistemit.

Që të tejkalohet dhe përmirësohet gjendja ekzistuese në Maqedoni duhet të vendoset dhe ndërtohet konsensus i vetëm nacional i cili do të mundësojë:

- funksionimin e sistemit të arsimit në kontinuitet pamvarësisht nga ndryshimet në rrethet partijake dhe politike (sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm të kualitetit dhe autonomisë relative);
- shkallë më e lartë e profesionalizimit çon kah apolitizimi
- identifikimi i orvatjeve dhe kontributit të çdo strukture politike për përmirësimin e arsimit dhe kujdesjes së fëmijëve dhe të rinjëve;
- ndërtimi i mekanizmave për integrim të pandërprerë të sistemit tonë të vlerave në sistemet e zhvilluara Europiane dhe të tjera;
- themelimi i komponentave infrastrukturale të vlerave të cilat arsimin e lirojnë nga ndikimet dhe mvarshmëritë politike në përgjithësi (zgjedhja e personelit, shfrytëzimi i qelësave të ndryshëm jopedagogjik dhe joprofesional, etj.);
- përforcimi i tendencave për arsim kualitativ i cili bazohet në kompetencat profesionale të bartësve të veprimëve arsimore;
- ndërtimi i mekanizmave dhe funksionimi i institucioneve me autonomi relative të cilat do ta përcjellin dhe vlerësojnë zhvillimin profesional të bartësve të veprimit arsimor (arsimtarët, drejtorët, dhe personelit tjetër profesional) në nivel lokal dhe nacional.

Theksohet nevoja për formimin e institucioneve me funksione qartë të definuara të cilat do të kujdesen për zhvillimin dhe përparimin profesional të arsimtarëve (shkallë të identifikuar të titujve sipas rezultateve të aritura- sistem i përparimit profesional);

- kyqje më aktive të Universiteteve (fakulteteve qe edukojnë kuadër të ardhshëm arsimor) në procesin e zhvillimit profesional të kuadrove të tyre;
- tejkalimi i modelit linear të finansimit të veprimit arsimor (kualiteti dhe arritjet e ndryshme në punë tani paguhen dhe vlerësohet në mënyrë të njejtë);
- përpunimi i nomenklaturës nacionale të kompetencave profesionale të arsimtarëve e cila duhet të jetë e ndërtuar edhe në sistemin e arsimit fillestar të tyre dhe në proceset e përsosshmërisë së tyre profesionale;
- autorizimi i veprimit të drejtorëve të shkollave dhe arsimtarëve;
- funksionimi i institucioneve për zhvillim profesional të drejtorëve të shkollave;
- përforcimi i mekanizmave dhe ekipimi i ekipeve profesionale për përkrahje të arsimtarëve dhe drejtorëve në nivel lokal dhe nacional;
- rritja e kapacitetit dhe ingerencave të shërbimeve inspektuese në nivel lokal dhe shtetëror;
- redefinimi i funksionit të shërbimeve profesionale nëpër shkolla me intervenim në edukimin e tyre fillestar, si dhe zhvillimin e programeve për

zhvillim të tyre profesional (ingerencat e Byros për zhvillim të arsimit dhe universiteteve);

- përforcimi i rolit të prindërve dhe bashkësisë lokale në përcjelljen e kualitetit arsimor;
- formimi i shërbimit specijal analitik për mbledhjen, përpunimin dhe ndërrimin e të dhënave për krahasim si në nivel nacional ashtu edhe në suaza ndërkombëtare (sipas standardeve, sipas temës, sipas shkallës së parë të llojit të arsimit dhe etj.), të cilat rezultate do të kenë rolin e indikatorëve të suksesit të çdo institucioni arsimor dhe çdo individi të kyqur në arsim (rejting shkalla nacionale e suksesit).

Ripërtirja e këtyre dhe mekanizmave të tjerë do ta lirojë arsimin nga çdo ndikim politik dhe ajo do të funksionojë si sistem me vlera të veta profesionale.

2. Palët e brengosura dhe përfitimi

Mendimet e përmendura janë në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të arsimit në RM-së dhe të gjitha subjekteve të interesuara për kualitetin e tyre;

- nxënësit/studentët (motivimi për mësim/studiim, proaktivitet në proceset edukative dhe mësimore, përgjegjësi dhe përkushtim më të madh për arsimimin personal dhe drejtueshmërinë profesionale, vlerësim objektiv të përparimit në mësim/studiim, pjesmarje në notim (vlerësim), bashkëpunim në nivel shkollor (punë ekipore), atmosferë demokratike në mësim/studiim, dituri kualitative dhe krahasuese, aftësi dhe zotësi konkurente në tregun e punës);
- arsimtarët (vlerësim objektiv të punës së tyre, vlerësim të teknikave inovative për bashkëkohësim të procesit arsimor, afirmimin e më të suksesshmive në saje të kriteriumeve dhe indikatorëve të njohura, motivim profesional për punë, stimulimi i më të suksesshmive);
- prindërit (besim më të madh në sistemin arsimor, stimulimi i pjesmarjes në përcjelljen e kualitetit të arsimit);
- bashkësija shoqërore në përgjithësi (funksionimi i sistemit arsimor nën baza konzistuese, matje të punës profesionale, mundësi më të mëdha për krahasimin e kualitetit, shpejtësimin e procesit të integritit në sistemet e zhvilluara arsimore).

Rekomandime

- Të ridefinohet funksioni i Byrosë për zhvillimin e arsimit dhe përkufizimi i tyre në lidhje me themelimin e institucionit relativisht të pavarur për ndërtimin e standardeve për përkrahjen dhe zhvillimin profesional të arsimtarëve dhe të shërbimeve profesionale në shkollat;
Ministria e arsimit të zhvillojë kriter sipas të cilit do të përcaktohen kualifikimet për drejtor;
Ky kriter duhet të jetë objektiv;
Anëtarësia/lidhja me parti politike nuk duhet të merret parasysh si kriter për zgjedhjen;

- Ministria e arsimit të jetë transparente në procedurat për zgjedhje të punësimeve të reja, në përparimin e të punësuarve në vendet e punës si dhe për largimin e tyre nga puna;
- Të përforcohet Inspektorati Shtetëror i arsimit;
- Të themelohet Qendër shtetërore për kërkime;
- Univerzitetet në Republikën e Maqedonisë duhet të bartin përgjegjësi për zhvillimin dhe udhëheqjen e stërviçjeve për drejtorë.

REKOMANDIME PËR FAKULTETET PEDAGOGJIKE

A. Arsim fillestar për arsimtarët

1. Redizajnimi i vazhdueshëm dhe modernizimi i planprogrameve arsimore për fakultetet pedagogjike

- Formimi i balansit funksional ndërmjet segmenteve profesionale dhe pedagogjiko-metodike të programeve arsimore
- Përdorimi i strategjive arsimore për arritjen e aftësive, në vend të diminitimit të njohurive teorike
- Intensifikimi i arsimit fillestar të arsimtarëve për realizimin e mësimit dylëndor

2. Inovimi i metodave dhe teknikave për të mësuarit

Arritja e aftësive profesionale për qasje interactive në punën me nxënësit për zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësit
Trajnim për zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ, pasqyrë pozitive për vetëveten dhe ndërtimin e vetëbesimit;
Ndryshime në metodën mësimore të gjuhës maqedonase si gjuhë joamësore

3. Aftësimi i arsimtarëve për demokraci dhe arsim multikulturor

- Arritja e aftësive profesionale për udhëheqje efektive në shkollat /klasat
- Trajnim për të vendosurit demokratik dhe participues
- Trajnim për të afërimit multikulturor në mësimin e historisë, literaturës dhe artit

B. Zhvillim profesional të arsimtarëve

Inovimi i metodave dhe teknikave për të mësuarit

Aftësim për demokraci dhe arsim multikulturor

Ndërtimi i modelit për zhvillim profesional të arsimtarëve në bazë të standardeve të vërtetuara për përparimin e tyre)

Autorizimi i institucioneve për realizimin e trajnimeve

C. Postkualifikimi arsimor i kuadrove nga fakultetet jopedagogjike

Intensifikimi i moduleve për teknikat dhe metodat e të mësuarit

Aftësim për demokraci dhe arsim multikulturor

Postkualifikim njëvjetor i kuadrove të fakulteteve pedagogjike sipas principit të mentorimit në suaza të institucionit që i punëson

INFRASTRUKTURA DHE PREGADITJET

1. Hapat preventive

Infrastruktura dhe pregaditjet paraqet çështje prioritative strategjike për zhvillimin e ardhshëm të arsimit. Kjo çështje ka rëndësi esencijale për:

Funksionimin e sistemit arsimor;

Përkrahje tekniko- teknologjike të procesit arsimor;

Realizimin e të drejtave të fëmijëve për arsimim të barabartë;

Shpejtimin e proceseve integruese të arsimit tonë në sistemet e zhvilluara arsimore

Theksohet nevoja për themelimin e Sistemit të stanadardeve për zbatimin e procesit arsimor në të gjitha shkallët e arsimit që kanë të bëjnë me:

Rregullimin hapësinoro-teknik të shkollave nga aspekti ekologjik dhe funksional (obore të rregulluara, barishta, gardhe të sigurta, bariera të larguara arkitektonike për fëmijët/studentët me të meta, etj.);

Standarde arsimore (mësim nëpër kabinete, pregaditje bashkëkohore, ndihmëse mësimore, laboratorit gjuhësore dhe kompjuterike, salla dhe terene për kulturë fizike, vende për të luajtur dhe hapësirë të organizuar për realizimin e aktiviteteve jashtë-mësimore të nxënësve);

Ekipimi kadrovik nga aspekti i kompetencave të defnuara profesionale të bartësve të procesit arsimor, menaxhmentit shkollor dhe ekipeve profesionale për përkrahje.

Përmirësimi i gjendjes në këtë lami është i determinuar nga kushtet materijale për të cilat në të ardhmën rol kyqës do të ketë edhe vetëçeverisja lokale. Jemi të mendimit se këtu bëhet fjalë për ndërimin e vlerave, qëndrimeve dhe besimit të të gjitha subjekteve dhe institucionet relevante nga lamija e arsimit.

2. Palët e interesuara dhe përfitimi

Problemet e pazgjedhura në lidhje me këtë çështje u interesojnë të gjitha subjekteve, të cilat në mënyrë direkte ose indirekte janë të kyqur në procesin arsimor:

Nxënësit/studentët të cilët qëndrojnë/mësojnë/studjojnë në kushte jo adekuade dhe atmosferë jostimiluese;

Kuadri arsimor, i cili ndjen frustrim profesional dhe demotivues;

Prindërit, të cilët edhe përkaj standardit personal/familjar, shprehin pakënaqësi për kushtet për punë në institucionet arsimore;

Shoqëria në përgjithësi

Nga funksionimi joadekuad i sistemit arsimor në aspekt të infrastrukturës dhe pregaditjes së shkollave nuk mundet dhe nuk guxon të përfitojë askush. Vetëm faktorët politik mund të përfitojnë.

3. Burime të informatave dhe ndihmës

Është i patjetërsueshëm vlerësimi objektiv dhe në krahasim më sistemet tjera në tranzicion i gjendjes në arsim, nga aspekti i problemeve infrastrukturale dhe

pregaditjes së institucioneve arsimore. Pikat strategjike në këtë plan kanë të bëjnë me aspektet si vijojnë:

sigurimi i të dhënave relevante për gjendjen në arsim (detektimi i gjendjes);
proektimi i nevojave objektive në përputhshmëri me standardet e caktuara;
ndarja e burimeve të përhershme të mjeteve të caktuara për mbajtjen dhe renovimin e kapaciteteve dhe burimeve të përhershme në institucionet arsimore

REKOMANDIME:

A. Formimi i njësisë burimoro-informative pranë Ministrisë për arsim dhe shkencë e cila do të mireshte me:

- Përcjelljen e gjendjes në të gjitha shkallët e arsimit;
- Përkrahjen e administratës së fakulteteve për përmirësimin e gjendjes materijalo-teknologjike
- Komunikimin me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare-donatorë

B. Formimi i njësisë burimoro-informative në nivel lokal i cili do të mireshte me:

- përcjelljen e gjendjes në arsim që janë në përgjegjësi të tyre
- përkrahja e menaxhmentit shkollor për përmirësimin e gjendjes
- ndërmjetësim dhe komunikim me biznesin lokal
- përkrahje dhe bashkëpunim me institucionet dhe autoritetet lokale
- komunikimi me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare-donatorët
- përkrahje dhe ndihmë të inicijativave proektuese të shkollave për bashkëkohësim, renovim dhe etj.

Lista e pjesmarësve në grupin për arsim

1. Venera Novakovska - Gjinnazi “NOVA” – Shkup
2. Sonja Arsovska – sektori joqeveritar (OJQ)
3. Vebi Bexheti - Universiteti i Evropës Juglindore
4. Violeta Petroska - Beshka – Universiteti “Sh. Qirili dhe Metodi”
5. Snezhana Adamçeska - Universiteti “Sh. Qirili dhe Metodi”
6. Emil Popovski - Universiteti “Sh. Qirili dhe Metodi”
7. Xheladin Murati - Universiteti “Sh. Qirili dhe Metodi” dhe Universiteti I Evropës Juglindore
8. Jusuf Arifi – Deputet në Parlamentin e RM-së
9. Metodija Stojanovski – Profesor në arsim të mesëm
10. Konstantin Petkovski – zëvendës drejtor në Byron për zhvillim të arsimit – Shkup
11. Dragan Nedeljkoviç – drejtor në Administratën për zhvillim dhe përparim të arsimit në gjuhën e pjestarëve të bashkësive
12. Miroslav Stojanov – Pedagog në shkollë të mesme
13. Slobodanka Qoseva - Universiteti “Sh. Qirili dhe Metodi”
14. Arafat Shabani - Universiteti i Evropës Juglindore